

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-130/12

**Prishtinë
12 prill 2013**

Në çështjen juridike të:

Sh. Sh.

Pala ankuese

kundër.

M.T. D.

Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesat e paraqitura kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/100/2011 (lëndët është e regjistruar në AKP me numrin KPA44661), i datës 23 shkurt 2011, pas shqyrtimit të mbajtur më 12 prill 2013, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Anulohet vendimi i Komisionit të Kërkesave Pronësore të Kosovës **KKPK/D/A/100/2011** i datës 23 shkurt 2011, për sa i përket lëndës së regjistruar në **AKP** me numrin **KPA44661** dhe kërkesa hidhet poshtë pasi që lënda nuk është nën kompetencën e **KKPK-së**.

- 2- Obligohet pala përgjegjëse në ankesë që t'i paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej € 45 (dyzet e pesë) brenda 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 2 gusht 2007, M.T. D. paraqiti një kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar konfirmimin e të drejtës së tij pronësore dhe ri-posedimin e një prone që ndodhet në Përlepnice, Gjilan, ngastra nr. 1351, një kopsht i klasit të dytë me sipërfaqe prej 4 ari dhe 41 m². Ai deklaroi se është pronar i kësaj ngastre dhe se e kishte humbur më 17 qershor 1999, si rezultat i rrethanave 1998/1999 në Kosovë. Lënda është regjistruar pranë AKP-së me numrin KPA44661.

Paraqitësi i kërkesës në AKP dorëzoi Fletën Poseduese nr. 251 të datës 3 qershor 2004 që tregonte se ngastra e kontestuar ishte e regjistruar në emër të M.T.D.

AKP gjeti Çertifikatën për të Drejtat e Paluajtshme Pronësore (UL-70403054-00251), sipas së cilës ngastra ishte e regjistruar në emër të M. T.D., paraqitësi i kërkesës.

Në vitin 2008, AKP e bëri të njohur kërkesën duke vendosur shenja në vendin ku pretendohet se ndodhet ngastra. Në vitin 2010, AKP përsëri bëri njoftimin e kërkesës por kësaj radhe duke e shpallur kërkesën në Gazetën e Njoftimeve nr. 4 dhe te Buletini i zyrës së pronave pranë UNHCR-së. Gazeta dhe Lista iu dhanë një pronari të një shitoreje në Përlepnice i cili pranoi që t'i vejë ato në dispozicion të palëve të interesuara. Këto publikime po ashtu u lanë në hyrje dhe dalje të fshatit Përlepnice, si dhe në disa zyre zyrtare në Gjilan.

Meqë askush nuk u përgjigj, kërkesa u trajtua si jokontesuese dhe **KKPK** me vendimin e vet **KKPK/D/A/100/2011** të datës 23 shkurt 2011 aprovoi kërkesën, duke vendosur që paraqitësi i kërkesës, M. T. D. kishte dëshmuar se ai ishte pronar i ngastrës dhe kishte të drejtë ta posedonte.

Më 10 gusht 2011, vendimi i KKPK-së iu dërgua paraqitësit të kërkesës.

Më 19 tetor 2012, Sh. H. (më tej: pala ankuese) paraqitësi një ankesë pranë AKP-së, duke deklaruar se ai i kishte blerë ngastrat 1350 dhe 1351 (ngastra e kërkuar) që ndodhen në Përlepnice në vitin 1980 nga fqinji i tij Sërb D. T. *(ka shumë gjasë që T. është një nofkë për T.)*. Ai shpjegoi se në prani të dëshmitarëve A. Sh. dhe O. Sh. ai i ka paguar D. T.– xhaxhait të paraqitësit të kërkesës – shumën prej 15.000,00 Dinar. Për më tepër, ai theksoi se në të njëjtën kohë ata kishin lidhur një kontratë private që është nënshkruar nga ai, dy dëshmitarët, dhe D. T. Gjithashtu, ai shpjegoi se kjo kontratë nuk ekziston më sepse ishte djegur bashkë me shtëpinë gjatë kohës së luftës. Ai vazhdoi duke shtuar se ngastrat 1350 dhe 1351 (ngastra e kërkuar) janë shfrytëzuar nga ai që nga viti 1980 pa ndonjë pengesë dhe se ai ende i ka në posedim këto ngastra. Në fund, ai deklaroi se vendimi i KKPK-së ishte i gabuar sepse vendimi ishte lëshuar në mungesë të dokumenteve, dhe kërkoi nga Gjykata Supreme e Kosovës që ta merr parasysht deklaratën e tij duke e trajtuar në mënyrë të drejtë. Ai dorëzoi në AKP padinë e dorëzuar pranë gjykatës komunale në Gjilan më 18 tetor 2012, foto planin kadastral dhe deklaratën e datës 18 tetor 2012.

Ankesa iu dërgua vajzës së paraqitësit të kërkesës (më tej: pala përgjegjëse në ankesë) (D. D.) më 27 nëntor 2012.

Më 21 dhjetor 2012, pala përgjegjëse në ankesë u përgjigj duke cekur se ka njohuri se xhaxhai i tij e kishte shitur ngastrën në fjalë në vitin 1982 dhe se askush nga familja e tij nuk e kishte shfrytëzuar më këtë ngastër. Për më tepër, ai theksoi se nuk konteston që vendimi i kundërshtuar të shpallet i pavlefshëm me kushtin që organet e Kosovës të mos e ngarkojnë me tatim lidhur me ngastrën 1351.

Më 21 dhjetor 2012, pala përgjegjëse në ankesë ka konfirmuar kërkesën për ta mbyllur kërkesën e aprovuar nga AKP për pronën e kontestuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e pranueshme ndonëse pala ankuese nuk ka qenë palë në procedurën para KKPK-së. Kjo rrethanë nuk mund t'i shkojë në dëm të palës ankuese pasi që në fakt ai nuk kishte qenë i njoftuar për kërkesën si duhet. Njoftimi është bërë përmes publikimit të kërkesës në Gazetën e Njoftimeve të AKP-së dhe në Buletinin e UNHCR-së. Kjo, megjithatë, përbën “përpjekje të arsyeshme” për ta bërë njoftimin për kërkesën sikurse parashihet me nenin 10.1 të rregullores vetëm në raste të veçanta. Një përjashtim i tillë nuk

mund të gjendet në këtë lëndë. Pasi që gjykata nuk mund ta përjashtojë faktin se pala ankuese nuk ka qenë në dijeni për kërkesën, ai duhet të pranohet si palë në procedurë, ankesa e tij është e pranueshme.

Në përgjigjen e tij ankesës pala përgjegjëse në ankesë deklaroi si në vijim:

“Unë deklaroj se jam e vetëdijshme se xhaxhai im T. D. e kishte shitur pronën në vitin 1982 dhe që nga atëherë familja ime nuk e ka shfrytëzuar këtë pronë.

Unë nuk kundërshtoj që vendimi i ankuar të shpallet i pavlefshëm me kusht që autoritetet e Kosovës të më mundësojnë shmangien nga pagesa e tatimit lidhur me ngastrën e kërkuar nr. 1351, me sipërfaqe prej 00 ha 04 ari 41 m2, përkatësisht që obligimet eventuale tatimore të paguhen nga pala ankuese”.

Kjo deklaratë duhet të konsiderohet si tërheqje e kërkesës (Neni 149 i Ligjit të Procedurës Kontestimore) që lejohet jo vetëm para KKPK-së por edhe në procedurën para Kolegjit të Apelit të AKP-së (Neni 193 i Ligjit të Procedurës Kontestimore).

Pas tërheqjes së kërkesës, pa ndonjë procedurë të mëtejme gjykata do të merr një aktgjykim me të cilin refuzon kërkesën të cilën paraqitësi i kërkesës e ka tërhequr. Kjo, megjithatë, ka si parakusht rregullin e përgjithshëm se lënda duhet të jetë nën kompetencën e gjykatës. Mirëpo, kjo lëndë nuk është nën kompetencën e KKPK-së/Kolegjit të Apelit të AKP-së.

Ndonëse KKPK si organ gjysmë-gjyqësor duke vendosur mbi meritat e kërkesës tashmë ka pranuar kompetencën e vet, gjykata *ex officio* vlerëson nëse lënda është nën kompetencën e vet (neni 195.1 b) i Ligjit të Procedurës Kontestimore).

Prandaj ky vendim i KKPK-së, për aq sa është e ankimuar, është dashur të anulohet dhe kërkesa të hidhet poshtë jo të refuzohet (neni 11.4 (a) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079).

Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, një paraqitës kërkesë ka të drejtë për një urdhër nga Komisioni për ri-posedimin e pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon jo vetëm të drejtën pronësore por edhe se ai apo ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Në këtë rast, megjithatë, pala përgjegjëse në ankesë pranon se kjo ngastër ishte “shitur apo dhënë një personi të tretë”.

Prandaj, humbja e pronës nuk është e ndërlidhur me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999 në Kosovë.

Si rrjedhojë, vendimi i KKPK-së lidhur me kërkesën është dashur të anulohet dhe kërkesa të hidhet poshtë pasi që nuk është nën kompetencën e KKPK-së dhe Gjykatës.

Shpenzimet e procedurës:

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore janë të vlefshme për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10,11 i UA 2008/2): € 30
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit, duke pasur parasysh se vlera e pronës ngastrës së kontestuar mund të përlogaritet të jetë më pak se € 1.000 (10.21, 10.15 dhe 10.1 të UA 2008/2): € 15.

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala përgjegjëse në ankesë që ka paraqitur një kërkesë të papranueshme. Përveç kësaj, paraqitësi i kërkesës/pala përgjegjëse në ankesë ka qenë i vetëdijshëm për këtë por megjithatë e ka paraqitur kërkesën. Ai e ka ditur se prona ishte shitur para shumë kohe dhe se familja e tij nuk e ka përdorur më pas. Sipas nenit 46 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë e më i gjatë se 90 ditë. Gjykata vendos se në këtë rast afati është 90 (nëntëdhjetë) ditë. Neni 47.3 parasheh që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it